LIGJ
Nr. 92/2022

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9665, DATË 18.12.2006, "PËR HUAMARRJEN SHTETËRORE, BORXHIN SHTETËROR DHE GARANCITË SHTETËRORE TË HUAS NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 156 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj emërtimi "ministri i Financave" zëvendësohet me fjalët "ministri përgjegjës për financat".

Neni 2

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 3
Kuptimi i garancisë shtetërore të huas

Garancia shtetërore e huas është detyrimi për pagesën nga buxheti i shtetit të detyrimeve financiare të një personi juridik apo fizik, që lindin nga një marrëveshje huaje për të cilën Republika e Shqipërisë ose Këshilli i Ministrave ka dalë garant, në rast se pala, që mban përgjegjësinë kryesore për pagesën e detyrimit financiar, nuk ka arritur ta paguajë atë në kohën dhe masën e duhur.

Garancia shtetërore e huas dokumentohet nëpërmjet një marrëveshjeje të lidhur me shkrim, e cila përmban rregulla për të drejtat dhe detyrimet e palëve, kushtet dhe mënyrat, sipas të cilave shteti është përgjegjës për detyrimet financiare të një huamarrësi, kur ai nuk arrin t'i paguajë ato në kohën dhe masën e duhur.".

Neni 3

Paragrafi i dytë i nenit 6 ndryshohet si më poshtë:

"Ministri përgjegjës për financat përgatit Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit dhe e paraqet atë për miratim në Këshillin e Ministrave. Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit vlerësohet dhe monitorohet rregullisht çdo vit nga ministri përgjegjës për financat. Ministri përgjegjës për financat harton një raport monitorimi të objektivave të vendosur në Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit dhe e dorëzon atë pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat, jo më vonë se tre muaj pas përfundimit të vitit. Raporti i monitorimit publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për financat. Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit rishikohet në rastet kur vlerësohet se kushtet e tregut të brendshëm dhe tregut të jashtëm financiar, si dhe treguesit makroekonomikë dhe fiskalë kanë ndryshuar duke u ndikuar nga ngjarje apo rrethana të jashtëzakonshme si katastrofa ose fatkeqësi natyrore, gjendje lufte, kriza financiare, si dhe ngjarje të cilat sjellin si rrjedhojë shmangie të parimeve dhe rregullave fiskale që lidhen me qëndrueshmërinë e

borxhit. Pavarësisht rasteve të përmendura në këtë paragraf, Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit do të rishikohet jo më vonë se një vit përpara përfundimit të afatit të strategjisë në fuqi. Strategjia e rishikuar miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 4

Në nenin 7 pas fjalëve "ministri përgjegjës për financat, në emër të" shtohet emërtimi "Republikës së Shqipërisë ose".

Neni 5

Pas nenit 7 shtohet neni 7/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 7/1
Qëllimi i lëshimit të garancisë shtetërore të huas

Ministri përgjegjës për financat, në emër të Republikës së Shqipërisë ose Këshillit të Ministrave, lëshon garanci shtetërore të huas:

a) për të mbështetur politikat e Këshillit të Ministrave për zhvillimin e sektorëve të ekonomisë;

b) për të mbështetur kreditimin e ndërmarrjeve shtetërore që veprojnë në sektorët kryesorë të sigurimit të shërbimeve dhe të mirave publike, me qëllim realizimin e projekteve të investimeve nga këto ndërmarrje;

c) për të mbështetur kreditimin e ndërmarrjeve private në zbatim të politikave të veçanta të Këshillit të Ministrave, për të mbështetur sektorë të caktuar të ekonomisë. Në këtë rast mund të përdoren skema të veçanta kolektive të garancive shtetërore, të referuara si "skema të veçanta të garancisë", ku ministri përgjegjës për financat lëshon një garanci me një vlerë të caktuar, në përfitim të një grupi apo kategorie të caktuar përfituesish dhe ku skema zbatohet nëpërmjet institucioneve financiare që ushtrojnë veprimtarinë e kredidhënies në vend. Menaxhimi i këtyre skemave të veçanta të garancive, duke përfshirë, por pa u kufizuar në procesin administrativ që ka të bëjë me verifikimin e kushteve dhe kritereve të dhënies së kredive nga institucionet financiare, monitorimin e zbatimit të skemave, menaxhimin e dokumentacionit, mbikëqyrjen dhe ndjekjen e kthimit të garancisë, do të mundësohet nga një institucion i caktuar me ligj për kryerjen e këtyre funksioneve, referuar në këtë ligj si "institucioni i caktuar me ligj për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive";

ç) për të mbështetur masat që mund të ndërmerren në rastet e ndonjë krize të sistemit financiar;

d) për të mbështetur ristrukturimin e portofolit ekzistues të garancive shtetërore të huas me qëllim reduktimin e nivelit të riskut.".

Neni 6

Në nenin 8 lidhëzat "dhe/ose" zëvendësohet me lidhëzën "ose":

Neni 7

Paragrafi i parë i nenit 9 ndryshohet si më poshtë:

"Kufizimet për shumën e borxhit shtetëror dhe për shumën e garancive shtetërore të huave përcaktohen në ligjin vjetor të buxhetit. Në ligjin vjetor të buxhetit vendoset kufiri për:

a) borxhin e ri të qeverisjes qendrore për t'u marrë në vitin buxhetor;

b) nivelin e borxhit të qeverisjes qendrore në fund të vitit;

c) garancitë e reja për t'u lëshuar gjatë vitit buxhetor nga qeveria qendrore;

ç) nivelin e garancive të qeverisjes qendrore në fund të vitit;

d) borxhin e emetuar për të mbuluar humbjet e bankës qendrore nga rivlerësimi i valutave.".

Neni 8

Në paragrafin e parë të nenit 13 pas fjalëve "pagimin në kohë të interesave" shtohen fjalët "detyrimeve të tjera".

Neni 9

Në nenin 26 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Fjalia e dytë e paragrafit të parë ndryshohet si më poshtë:

"Në rastet kur merret hua nga kreditorë privatë, përzgjedhja e kreditorit bëhet nëpërmjet procedurave të përzgjedhjes, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.".

2. Paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

"Ministri i Drejtësisë, me kërkesë të ministrit përgjegjës për financat, lëshon një opinion ligjor, sipas rastit, për marrëveshjet e huas ose të garancisë shtetërore që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë ose të Këshillit të Ministrave, i cili vërteton zbatimin e rregullt të dispozitave ligjore në fuqi për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve përkatëse, ligjshmërinë e përmbajtjes së marrëveshjeve të nënshkruara, si dhe hyrjen në fuqi të tyre në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.".

3. Pas paragrafit të fundit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Në marrëveshjet që do të lidhen nga ministri përgjegjës për financat për realizimin e huamarrjes në tregjet ndërkombëtare lejohen parashikimet e kushtëzuara për heqjen dorë nga imuniteti. Mbajtësit jorezidentë të instrumenteve të borxhit të marrë në tregjet ndërkombëtare, qofshin persona fizikë jorezidentë në Shqipëri apo entitete jorezidente pa një seli të përhershme në Shqipëri, përfshirë menaxherët bashkëdrejtues, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat në Shqipëri për të gjitha transaksionet dhe veprimtaritë që lidhen me emetimin, mbajtjen, ruajtjen e tregtimin e instrumenteve të borxhit, si dhe nga ndonjë tatim indirekt apo taksë tjetër e aplikueshme në Republikën e Shqipërisë.".

Neni 10

Në fund të fjalisë së parë të nenit 29 shtohen fjalët "përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen përkatëse të huas.".

Neni 11

Pas paragrafit të tretë të nenit 30 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

"Në rast se huamarrësit nuk shlyejnë detyrimet e krijuara në kuadër të këtyre marrëveshjeve, ministria përgjegjëse për financat nëpërmjet institucionit të caktuar me ligj për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive, me anë të një urdhri me shkrim kërkon bllokimin e llogarive dhe sekuestrimin e shumës në vlerën e detyrimit të papaguar nga huamarrësi kundrejt ministrisë përgjegjëse për financat dhe ndjek shlyerjen e plotë të detyrimit.

Urdhri i nxjerrë sipas paragrafit të katërt të këtij neni përbën titull ekzekutiv sipas shkronjës "e" të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile dhe ngarkohet zyra përmbarimore për ekzekutimin e tij.".

Neni 12

Paragrafi i dytë i nenit 34 ndryshohet si më poshtë:

"Garancia shtetërore e huas konvertohet në borxh shtetëror nëse pagesa apo pagesat e papaguara për huan për të cilën është dhënë garancia, nuk janë bërë në përputhje me kushtet dhe afatet e huas, duke shkaktuar në këtë mënyrë mospërmbushjen e detyrimit të huamarrësit.".

Neni 13

Pas paragrafit të dytë të nenit 35 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Në rastet e skemave të veçanta të garancive, kërkesa me shkrim do t'u paraqitet institucioneve huadhënëse të përfshira në skemë, të cilat vlerësojnë kushtet financiare dhe aftësinë e pagimit nga huamarrësi.".

Neni 14

Në nenin 36 pas paragrafit ekzistues shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Në rastet e skemave të veçanta të garancive, institucionet e caktuara për dhënien e huas, sipas skemave të veçanta të garancive, shqyrtojnë dhe marrin vendimin në lidhje me kërkesat e depozituara pranë tyre në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, që ka miratuar skemën përkatëse të garancisë.".

Neni 15

Neni 38 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 38
Dhënia e garancisë shtetërore të huas

1. Ministri përgjegjës për financat, në emër të Republikës së Shqipërisë ose Këshillit të Ministrave, miraton dhënien e garancisë shtetërore të huas pasi shqyrton dokumentet e mëposhtme:

a) projektmarrëveshjen e huas ndërmjet institucionit huadhënës dhe huamarrësit;

b) projektmarrëveshjen e garancisë ndërmjet institucionit huadhënës dhe shtetit;

c) projektmarrëveshjen e mirëkuptimit ndërmjet huamarrësit dhe shtetit.

2. Në rastin e skemave të veçanta të garancive, të cilat menaxhohen nga institucioni i caktuar me ligj për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive, ministri përgjegjës për financat, në emër të Republikës së Shqipërisë ose Këshillit të Ministrave, miraton:

a) termat kryesorë të huas ndërmjet institucionit huadhënës dhe huamarrësit;

b) projektmarrëveshjen e garancisë ndërmjet institucionit huadhënës dhe shtetit;

c) projektmarrëveshjen tip të mirëkuptimit që do të nënshkruhet nga huamarrësi.

3. Përpara nënshkrimit të marrëveshjes së garancisë, Këshilli i Ministrave vendos:

a) miratimin për dhënien e garancisë në rastet e pikës 1 të këtij neni; ose

b) miratimin për skemën e veçantë të garancive në rastet e pikës 2 të këtij neni.".

Neni 16

Neni 39 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 39
Dokumentacioni i garancisë shtetërore të huas

Ministria përgjegjëse për financat është e detyruar të ruajë të gjitha marrëveshjet e huas, marrëveshjet e garancisë dhe marrëveshjet e mirëkuptimit, të miratuara në bazë të këtij ligji. Në rastin e skemave të veçanta të garancisë, marrëveshjet e huas dhe mirëkuptimit do të ruhen nga institucioni i caktuar me ligj për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive.

Ministria përgjegjëse për financat ka detyrim ligjor të marrë në dorëzim dhe të ruajë të gjitha dokumentet që ndodhen në ministritë dhe institucionet shtetërore, në bazë të të cilave janë dhënë garancitë shtetërore të huas, huat e të cilave janë ende të papaguara.

Ministria përgjegjëse për financat mban të dhëna për garancitë shtetërore të huas në regjistrin e garancive shtetërore të huas në përputhje me këtë ligj. Çdo institucion tjetër, i caktuar me ligj për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive, raporton rregullisht në ministrinë përgjegjëse për financat të dhënat për garancitë që menaxhon. Përmbajtja dhe frekuenca e raportimit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.".

Neni 17

Neni 42 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 42
Pagesa për një garanci shtetërore të huas

Kur huamarrësi nuk ka mundësi të kryejë pagesën/pagesat në përputhje me kushtet dhe afatet e marrëveshjes së huas, të përcaktuara për këtë qëllim, njofton menjëherë ministrinë përgjegjëse për financat. Pas këtij njoftimi, ministria përgjegjëse për financat verifikon paaftësinë paguese të huamarrësit sipas paragrafit të katërt të këtij neni. Për kryerjen e këtij verifikimi, ministria përgjegjëse për financat është e autorizuar që nëpërmjet institucionit të caktuar me ligj për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive, të kërkojë dhe të marrë nga bankat informacion mbi gjendjen e llogarive bankare të subjekteve përfituese të garancisë.

Kërkesa për pagesë mund t'i vijë ministrisë përgjegjëse për financat edhe nga institucioni huadhënës.

Në zbatim të detyrimeve që lindin nga marrëveshja e garancisë, me marrjen e njoftimit/kërkesës të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni, ministri përgjegjës për financat autorizon kryerjen e pagesës në përputhje me përcaktimet e marrëveshjeve të huas dhe garancisë. Pagesa kryhet përpara dhe pavarësisht rezultatit të verifikimit të aftësisë paguese të huamarrësve.

Ministria përgjegjëse për financat, nëpërmjet institucionit të caktuar me ligj për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive, kryen verifikimin e aftësisë paguese të huamarrësve. Nëse nga ky verifikim rezulton se ka mundësi pagese dhe në rast se pagesa e detyrimit është kryer nga ministria përgjegjëse për financat, institucioni i caktuar me ligj për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive, me anë të një urdhri me shkrim kërkon bllokimin e llogarive dhe sekuestrimin e kundërvlerës që ministria përgjegjëse për financat ka paguar dhe ndjek shlyerjen e plotë të detyrimit.

Urdhri i nxjerrë sipas paragrafit të katërt të këtij neni përbën titull ekzekutiv.

Në rastin e skemave të veçanta të garancisë, kërkesa për pagesë trajtohet nga institucioni i caktuar me ligj për administrimin e skemave të veçanta të garancisë, i cili kryen verifikimin e përputhshmërisë së kërkesës për pagesë me kushtet e përcaktuara në marrëveshjen e huas. Institucioni i caktuar me ligj për administrimin e skemave të veçanta të garancisë përcjell kërkesën për pagesë pranë ministrit përgjegjës për financat jo më vonë se 20 ditë pune.

Ministri përgjegjës për financat autorizon transfertën e pagesës ose pagesave për institucionin huadhënës brenda 15 ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit.".

Neni 18

Në nenin 43 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parë fjalët "në llogarinë e garancisë shtetërore të huas" zëvendësohen me fjalën "ndaj".

2. Paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

"Ministri përgjegjës për financat, nëpërmjet institucionit të caktuar me ligj për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive, ndërmerr të gjitha masat e paracaktuara në këtë ligj, në ligje të tjera në fuqi dhe në marrëveshjen e mirëkuptimit, për rikuperimin e garancisë së përftuar nga huamarrësi për çdo pagesë të bërë sipas garancisë, duke përfshirë edhe kostot që lidhen me të, referuar të gjitha garancive shtetërore të lëshuara sipas objektit të këtij ligji, si dhe garancive të tjera të lëshuara para hyrjes në fuqi të tij.".

Neni 19

Në paragrafin e dytë të nenit 46 hiqen fjalët "si dhe për vlerësimet e detyrimeve fillestare dhe korrente në monedhë vendase dhe në monedha të huaja".

Neni 20

Në nenin 47 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në paragrafin e dytë hiqen fjalët "të regjistruar çdo gjashtë muaj".

2. Në paragrafin e tretë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Institucioni i caktuar me ligj për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive raporton rregullisht në ministrinë përgjegjëse për financat të dhënat e regjistrit për garancitë që ajo menaxhon, sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për financat.".

Neni 21

Në fund të nenit 51 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 26 të këtij ligji.".

Neni 22

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar, më datë 22.12.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13, datë 16.1.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.